- j) Fondi 4, Dosja nr.123, Viti 1947 UNRRA, Dosja nr.123, Viti 1947 UNRRA Mbi aktivitetin e zbulimit amerikan pas prishjes se marrëdhënieve dhe largimit të tyre nga Shqipëria pre 17 (shtatëmbëdhjetë) faqe.
- k) Fondi 4, Dosja nr.82, Viti 1946 UNRRA, Materiale operative për zbuluesin amerikan Joseph Jacobs prej 36 (tridhjetë e gjashtë) faqe.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtar:** Altin Hoxha, Dr. Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

# BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH



## **BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 03.05.2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me vendimin nr.26, datë 12.11.2020 si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

Deklasifikimi i plotë i dosjeve:

1. Dosje personale dhe pune nr.5648, në ngarkim të Gj. P. P., me 209 (dyqind e nëntë fletë). Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
2. Fashikull nr. 7659, në ngarkim të Xh. Sh. N., kategoria 2/A me 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Fashikulli i përket Fondit Kosova.
3. Fashikull nr. 6320, në ngarkim të E. I. M., 2 volume me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1964-1978. Fashikulli i përket Fondit Kosova.
4. Fashikull nr. 2879, në ngarkim të A. L. Ç., me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1968-1987. Fashikulli i përket Fondit Kosova.
5. Fashikull nr. 136, në ngarkim të A. R. H., me 313 (treqind e trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1966-1987. Fashikulli i përket Fondit Kosova.
6. Fashikull nr. 2923, në ngarkim të I. I. A., me 141 (njëqind e dyzetë e një) fletë + 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë në zarf + 1 kartelë përpunimi model 5. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Fashikulli i përket Fondit Kosova.
7. Fashikull nr. 3269, në ngarkim të R. M. I., me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1970-1986. Fashikulli i përket Fondit Kosova.
8. Fashikull nr. 2818, në ngarkim të M. I. B., 2 volume me 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1971-1987. Fashikulli i përket Fondit Kosova.



9. Dosje formulare nr. 1692, në ngarkim të A. F. E., me 5 vëllime me 1095 (një mijë e nëntëdhjetë e pesë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1946-1990. Dosja i përket Fondi Drejtoria e II – të.
10. Shkresa nr.19 Prot., datë 06.03.2019 me lëndën “Kthim përgjigje shkresës mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor për shtetasin A. L. M.” drejtuar Drejtorisë së Informacionit” për dijener Sekretarit të Përgjithshëm.
11. Dosje nr. 106 “A”, në ngarkim të N. V. O., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1946-1952. Dosja i përket Fondit Operativ.
12. Dosje agjenturale “Mistreci” nr. 382, në ngarkim të F. S. H., me 166 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1977-1982. Dosja i përket Fondit Operativ.
13. Dosje formulare nr. 2893 dhe fashikull personal për të dënuar nr. 2656/1, në ngarkim të K. S. B., me 249 (dyqind e dyzet e nëntë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1959-1982. Dosja i përket fondit Operativ.
14. Dosje nr. 23 Grupi i Sillogut Vorio Epirot Himariot të vitit 1945, në ngarkim të K. Ll. M., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1946-1984. Dosja i përket fondit Operativ.
15. Kartelë model 1 nr. 3970, në ngarkim të Gj. P. G., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Sekret”. Kartela daton në vitin 1980. Kartela i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
16. Dosje përpunimi nr. 4701, në ngarkim të S. H. P., me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1970-1990. Dosja i përket fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier.
17. Dosje personale dhe pune nr. 6843, në ngarkim të R. M. O. (M.), me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1985-1989. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
18. Dosje formulare nr. 669, në ngarkim të Xh. M. I., me 143 (njëqind e dyzet e tre) fletë + kartelë model 1. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1966-1982. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Pogradec.
19. Dosje përpunimi nr. 3313, në ngarkim të L. P. Ç., me 70 (shtatëdhjetë) fletë dhe një zarf me fotografi. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1960-1992(viti 1992 është vendimi i arkivimit). Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.
20. Dosje përpunimi nr. 11676, në ngarkim të S. L. Ç., me 191 (njëqind e nëntëdhjetë e një) fletë dhe kartelë model 1. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1987. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

21. Dosje personale nr. 14573, në ngarkim të S. L. Ç., me 24 (njëzet e katër) fletë dhe zarf me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1987-1990. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
22. Kartelë model 2 nr. 182, në ngarkim të N. V. Z., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të kartelës është “Tepër Sekret”. Kartela daton në vitin 1986. Kartela i përket fondit Dega IV.
23. Dosje formulare nr. 3892, në ngarkim të U. R. E. me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë dhe kartelë model 1. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1976-1980. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
24. Dosje përpunimi nr. 2288, në ngarkim të D. M. D., me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë dhe kartelë model 1. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1975-1990. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Krujë.
25. Dosje përpunimi nr. 11928, në ngarkim të J. Sh. Gj., me 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1987-1989. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
26. Dosje agjenturale “Shushunjat” nr. 129, me 2 fashikuj me 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitin 1977. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Lushnje.
27. Dosje personale dhe pune nr.10305, në ngarkim të Z. M. P., me 62 (gjashtëdhjetë fletë). Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1975-1983. Dosja i përket fondit Operativ
28. Shkresa nr.7/4 Prot datë 20.05.2019 me lëndën “Informacion mbi dorëzimin e dokumenteve të fotokopjuara në përmbushje të përgjigjeve të praktikave të ndryshme nga Sektori i Përpunimit” drejtuar Drejtorisë së Informacionit” për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm.
29. Dosje personale nr. 83/1, në ngarkim të N. V. J., me 54 (pesëdhjetë e pesë) fletë + 14 (katërmëdhjetë) fletë në zarf + kartelë model 2 (një) fletë dhe kartelë model 4 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumenteve është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1954-1991. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II-të.
30. Dosje personale dhe pune nr. 6005, në ngarkim të Q. A. H., 2 vëllime me 306 (treqind e gjashtë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978-1990. (vendim arshivimi në vitin 1992). Dosja i përket Fondit të Veçantë.
31. Dosje nr. 963 formulare, personale dhe pune, në ngarkim të I. Sh. V., me 4 vëllime me 421 (katërqind e njëzet e një) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1955-1987. Dosja i përket fondit Fondi i Veçantë.
32. Historiku i Organeve të Sigurimit të Shtetit. Niveli i klasifikimit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1976. Historiku i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Pukë.
33. Fashikull me lista mbi karakteristikat e të arratisurve, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë + 1 (një) hartë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1946-1969. Fashikulli i përket fondit Kosova

34. Historiku i Bandës së K. S. Ç., me 41 (dyzetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1963. Historiku i përket Fondi Drejtoria e II-të.
35. Historiku i Bandës së A. T., me 41 (dyzetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të është “Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1949-1953. Historiku i përket Fondi Drejtoria e II-të.
36. Historiku i Bandës së T. H., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1953-1955. Historiku i përket Fondi Drejtoria e II-të.
37. Historiku i Bandës së H. G., me 41 (dyzetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë nga vitin 1944-1954. Historiku i përket Fondi Drejtoria e II-të.
38. Historiku i Bandës së K. D., me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1945-1965. Historiku i përket Fondi Drejtoria e II-të.
39. Historiku i Bandës së U. (Zh.) Sh., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumenti daton në vitin 1949-1966. Historiku i përket Fondi Drejtoria e II-të.
40. Fashikull “Grupi Indipendent me qendër në Belgjikë” nr. 87, me 200 (dyqind) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë 1961-1987. Fashikulli i përket Fondi Drejtoria e II-të.
41. Fashikull “Grupi Indipendent me qendër në R. F. Gjermane”, me 14 (katërbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë 1964-1975. Fashikulli i përket Fondi Drejtoria e II-të.
42. Fashikull “Grupi Indipendent me qendër në Francë”, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë 1964-1973. Fashikulli i përket Fondi Drejtoria e II-të.
43. Historiku i bandave që kanë qarkulluar në rrethin e Gramshit në vitet 1945-1962, me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1964-1965. Historiku i përket Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh.
44. Procesverbale të të pandehurit H. M., viti 1953, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1953-1962. Dokumentet i përkasin Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh.
45. Kartelë Model 2, nr. 8088, në ngarkim të H. H. O., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
46. Kartelë Model 2, nr. 112, në ngarkim të B. F. I., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
47. Kartelë Model 2, nr. 16, në ngarkim të S. S. M., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
48. Kartelë Model 2, nr. 198, në ngarkim të R. H. M., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.

49. Kartelë Model 2, nr. 1877, në ngarkim të Z. F. D., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
50. Kartelë Model 2, nr. 3580, në ngarkim të G. B. T., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
51. Kartelë Model 2, nr. 795, në ngarkim të A. K. D., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
52. Kartelë Model 2, nr. 3225, në ngarkim të A. J. D., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
53. Kartelë Model 2, nr. 4026, 20838, në ngarkim të B. D. K., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.
54. Kartelë Model 2, nr. 5693 në ngarkim të F. K. Sh., me 1 (një) fletë. Kartela i përket fondit Dega IV.

**I. Deklasifikimi pjesërisht i informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që gjendet në dokumentin si më poshtë:**

1. Fletë regjistri i Regjistrimit të Agjunkturës model nr.2, konkretisht rreshti me nr. rendor 15.907, në ngarkim të A. L. M., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrimit është “Tepër Sekret”. Dokumenti i përket Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
2. Fletë regjistri i agjunkturës nr. 49, datë 25.12.1976, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 126, në ngarkim të H. H. O., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.
3. Fletë regjistri nr. 11, datë 19.06.1975, regjistri themeltar i agjunkturës, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 112, në ngarkim të B. F. I., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.
4. Fletë regjistri nr. 12, datë 19.06.1975, regjistri i agjunkturës, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 16, në ngarkim të S. S. M., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.
5. Fletë regjistri nr. 11, datë 19.06.1975, regjistri themeltar i agjunkturës, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 198, në ngarkim të R. H. M., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.
6. Fletë regjistri i agjunkturës nr. 49, datë 25.12.1976, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 1877, në ngarkim të Z. F. D., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.
7. Fletë regjistri i regjistrimit të agjunkturës, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 3207, në ngarkim të G. B. T., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier.
8. Dosje personale dhe pune nr. 110, në ngarkim të M. H. O., konkretisht, nga dosja personale karakteristike punedhe nga dosja e punës nr. 110/1, 5 (fletë). Niveli i klasifikimit është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Ersekë.

9. Fletë regjistri i agjunkturës nr. 1, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 3148, në ngarkim të A. K. D., me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit i regjistrit është “Tepër Sekret”. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
10. Fletë regjistri i agjunkturës nr. 1, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 3225, në ngarkim të A. J. D., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier.
11. Fletë regjistri i agjunkturës nr. 1, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 4055, në ngarkim të B. D. K., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier.
12. Fletë regjistri i agjunkturës nr. 1, konkretisht rreshti ku ndodhet numri rendor 4129, në ngarkim të F. K. Sh., me 1 (një) fletë. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier.
13. Dosje Personale nr. 2234, në ngarkim të D. V. Ç., konkretisht 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
14. Dosje Personale nr. 3034, në ngarkim të N. A. K., konkretisht 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
15. Dosje Pune nr. 3034/2, në ngarkim të N. A. K., konkretisht 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
16. Dosje Pune nr. 3034/3, në ngarkim të N. A. K., konkretisht 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
17. Dosje Pune nr. 3034/4, në ngarkim të N. A. K., konkretisht raport i datës 18.03.1967. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Operativ.
18. Dosje Pune nr. 696, në ngarkim të Q. K. H., konkretisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë 21.04.1966. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
19. Dosje Pune nr. 2337, në ngarkim të V. A. M., konkretisht konkretisht 5 (pesë)flete. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
20. Dosje Pune nr. 1121, në ngarkim të Sh. A. B., konkretisht 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
21. Dosje Pune nr. 4442, në ngarkim të E. Xh. K., konkretisht 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
22. Dosje Pune nr. 7017, në ngarkim të Th. N. M., konkretisht 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
23. Dosje Pune nr. 8847, në ngarkim të A M V, konkretisht 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.

24. Dosje Pune nr. 6953, në ngarkim të S. Sh. K., konkretisht 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Elbasan.
25. Dosje Personale nr. 7241, në ngarkim të H. Q. A. (H.), konkretisht 5 (pesë) fletë Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
26. Dosje Pune nr. 7241, në ngarkim të H. Q. A. (H.), konkretisht 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
27. Dosje Personale nr. 4994, në ngarkim të S. I. B., konkretisht 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.
28. Dosje Personale nr. 4160, në ngarkim të Y. M. T., konkretisht 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
29. Dosje Personale nr. 3516, në ngarkim të M. A. Gj., konkretisht 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Gjirokastër.
30. Dosje Personale nr. 12677, në ngarkim të Ll. A. L., konkretisht 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
31. Dosje Personale nr. 4502, në ngarkim të Minush Masar Jero, konkretisht 4 (katër). Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Durrës.

## **BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 03.05.2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me vendimin nr.27, datë 11.12.2020 si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

Deklasifikimii i plotë i dosjeve:

1. Dosje personale dhe pune nr.5648, në ngarkim të Gj. P. P., me 209 (dyqind e nëntë fletë). Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
2. Dosje përpunimi nr. 11905, në ngarkim të R. M., me 200 (dyqind) fletë, zarf me 13 (trembëdhjetë) fletë dhe një fletore, si dhe 1 (një) kartelë Model 1. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1970-1990. Dosja i përket ish Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
3. Dosje formulare nr. 12856, në ngarkim të M. S., me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë dhe 2 (dy) kartela Model 1. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1970-1990. Dosja i përket ish Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
4. Dosje formulare nr. 937, në ngarkim të V. P., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1958-1960. Dosja i përket Fondit Operativ.
5. Dosje agjenturale me pseudonimin “Foleja e Gjarprit”, dy fashikuj me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet datojnë në vitet 1978-1985. Dosja i përket ish Fondit Dega e Punëve të Brendshme Vlorë.
6. Dosje personale dhe pune nr. 931, në ngarkim të T. Z., përkatësisht me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë dhe 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.
7. Dosje kërkimi nr. 391, në ngarkim të T. Z., me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë deri në vitet 1972. Dosja i përket Fondit Operativ.
8. Dosje formulare nr. 4479, në ngarkim të Sh. H., me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1953. Dosja i përket Fondit Kosova.
9. Fashikull nr. 1521, në ngarkim të Q. B., me 2 vëllime me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë dhe një zarf me kartela, fotografi dhe kartolina. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1963-1975. Dosja i përket Fondit Kosova.
10. Dosje agjenturale nr. 164 “Pseudodemokrati”, 3 volume përkatësisht me 200 (dyqind) fletë, 284 (dyqind e tetëdhjetë e katër) fletë dhe 229 (dyqind e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1990. Dosja i përket ish Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
11. Libër i Fondit Sekret (Veçantë) 1987,1988,1989,1990 dhe 1991, me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1987-1990. Dokumenti i përket ish Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
12. Regjistër i veprimeve të kryera me T.O nr. 39, me 101 (njëqind e një) fletë. Niveli i dokumentit është “Sekret”. Dokumenti daton në vitet 1970-1989. Dokumenti i përket ish Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

13. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, vendim i datës 14.09.1988 për shpenzimin e 15 (pesëmbëdhjetë) lekëve nga fondi sekret për përballimin e shpenzimeve të dhomës nr. 112 në Hotel "Iliria" dhe vërtetim i datës 15.09.1988 i pagesës për përdorimin e dhomës, me 2 (dy) fletë në total. Niveli i dokumentit është "Sekret". Dokumenti daton në vitet 1988.
14. Dosje përpunimi nr. 407, në ngarkim të F. M., me 200 (dyqind) fletë dhe një zarf me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret". Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1954-1990. Dosja i përket ish Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.
15. Fondi nr.6, Drejtoria e III-të, Viti 1964, Dosje kërkimi nr. 854 mbi përpunimin agjentalo operativ të të arratisurit A. M., kapur dhe asgjësuar më 1964", me 178 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit "tepër sekret". Dokumentet datojnë nga viti 1954-1964.
16. Fondi nr.6, Viti 1953, Dosja nr.391, Buletin informativ me të dhëna mbi veprimtarinë armiqësore të shteteve kapitaliste e të emigracionit reaksionar shqiptar jashtë shtetit kundër vendit tonë", me 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1953.
17. Fondi nr.6, Viti 1954, Dosja nr. 427, "Relacione dhe informacione mbi gjendjen dhe aktivitetin e emigracionit reaksionar shqiptar jashtë shtetit si dhe organizatat e tyre reaksionare", me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1954.
18. Fondi nr.6, Viti 1954, Dosja nr.434, "Raport i Degës I (të zbulimit politik) mbi gjendjen politike në Itali partitë politike, gjendja ushtarake, dhe organizimi i forcave të armatosura italiane, gjendja ekonomike dhe mbi organet e zbulimit e veprimtaria e tyre kundër vendit tonë", me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1954.
19. Fondi nr.6, Viti 1955, Dosja nr. 443, "Raporte vjetore mbi veprimtarinë e drejtësisë së zbulimit politik në drejtim të aktivitetit armiqësor të emigracionit reaksionar shqiptar dhe zbulimeve kapitaliste kundër vendit tonë", me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë nga viti 1955-1956.
20. Fondi nr.6, Viti 1954, Dosja nr.442, "Relacione informative mbi gjendjen dhe aktivitetin e vendeve imperialiste dhe emigracionit reaksionar shqiptar kundër vendit tonë", me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1954.
21. Fondi nr.6, Viti 1955, Dosja nr.463, "Raport mbi analizën e punës të seksionit I-rë për organizimin e punës në drejtim të zbulimeve kapitaliste dhe të emigracionit reaksionar shqiptar jashtë vendit", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë nga viti 1955-1956.
22. Fondi nr.6, Viti 1955, Dosja nr. 465, "Relacion dërguar Ministrin të Punëve të Brendshme, mbi nevojën e zgjerimit dhe përgatitjen e kuadrove për ngritjen e rezidencave ilegale jashtë shtetit", me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Tepër Sekret". Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1955.



23. Fondi nr.6, Viti 1956, Dosja nr. 506 “Relacion dhe informacion i hollësishëm mbi gjendjen, organizimin dhe veprimtarinë e emigracionit reaksionar shqiptar jashtë shtetit kundër vendit tonë”, me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1956.
24. Fondi nr.6, Viti 1956, Dosja nr. 505, “Të dhëna informative nga burimet e zbulimit politik mbi gjendjen dhe veprimtarin e të arratisurve shqiptar dhe listat e tyre në kampet e përqendrimit të tyre në Itali”, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1956.
25. Fondi nr.6, Viti 1956, Dosja nr. 504, “Të dhëna informative nga burimet e zbulimit politik mbi veprimtarinë armiqësore të emigracionit politik reaksionar dhe shteteve kapitaliste nëpërmjet organizatave “Asambleja e Kombeve Evropiane të realizuara Evropa e Lirë” dhe “Asambleja Botërore e Lirisë”, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1956.
26. Fondi nr.6, Viti 1957, Dosja nr. 537, “Raport pune mbi veprimet agjenturalo-operative në drejtim të emigracionit reaksionar shqiptar në Francë dhe Amerikë”, me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1957.
27. Fondi nr.6, Viti 1957, Dosja nr.547, “Raport vjetor dhe relacione mbi veprimtarinë armiqësore të jashtme kundër Rep. Pop. Shqiptare dhe aktiviteti i emigracionit reaksionar shqiptar jashtë shtetit”, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1957.
28. Fondi nr.6, Viti 1957, Dosja nr. 546, “Mbi zbulimin e amnistisë së shpallur nga përfundimi i Kuvendit Popullor për emigracionin reaksionar jashtë shtetit, informacione e relacione për këtë problem dhe vendimi i Byrosë Politike të P.P.Sh-së për zgjatjen e afatit të amnistisë”, me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1957.
29. Fondi nr.6, Viti 1957, Dosja nr. 539, “Relacione mbi gjendjen politike në Egjipt pas revolucionit të korrikut 1952, grushti i shtetit që rrëzoi mbretin Faruk dhe masat e mëvonshme për stabilizimin e gjendjes së brendshme e të jashtme në Egjipt”, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1957.
30. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 687 “Për disa të dhëna mbi reagimet e komentet për krijimin e Partisë Demokratike dhe rreth situatës aktuale”, me 14 (katërbëdhjetë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
31. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1991, Dosja nr.111 “Për disa probleme që kanë ngritur drejtuesit e Partisë Demokratike për depolitizimin e forcave të ruajtjes së rendit”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1991. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
32. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 647 “Disa të dhëna për organizime dhe demonstrata në Tiranë dhe Shkodër”, me 7 (shtatë)fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

33. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 643 “Informacion për intesifikimin e veprimtarisë armiqësore në Tiranë”, me 9 (nëntë) fletë. Dokumentet datojnë nga vitin 1990 deri 1991. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
34. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 644 “Për disa të dhëna që bëjnë për manifestime e grumbullime të ndryshme”, me 7(shtatë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
35. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 637 “Për zbulimin e parandalimin e një veprimtarie armiqësore të organizuar në qytetin e Tiranës”, me 8 (tetë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
36. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 636 “Informacion për punën e bërë për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë armiqësore të organizuar në qytetin e Tiranës që ndiqet në problemin e centralizuar “Pseudodemokratët”, me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
37. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 642 “Informacion për veprimtarinë armiqësore të organizuar në qytetin e Tiranës dhe për disa të dhëna që bëjnë fjalë për manifestime e grumbullime të ndryshme”, me 23 (njëzet e tre) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
38. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 634 “Për organizimin e një demonstrate dhe disa të dhëna e komente armiqësore në qytetin e Shkodrës”, me 4 (katër) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
39. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1990, Dosja nr. 633 “Për të dhënat e komentet e marra pas ngjarjes së datës 13.12.1990 në qytetin e Shkodrës”, me 6 (gjashtë) fletë. Dokumentet datojnë nga vitin 1990 deri 1991. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
40. Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1991, Dosja nr. 52 “Për takimin e S. B. e N. C. me ambasadorin francez”, me 2 (dy) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1991. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
41. Fondi nr.6, Drejtoria e III, Viti 1945, Dosja nr.19/2 “Dosje fashikullore me dokumenta mbi veprimtarinë armiqësore të kriminelit të luftës Q. M. gjatë luftës e pas çlirimit në arrati”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dokumentet datojnë nga vitin 1945-1957. Niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”.

**KRYETARI I KDZH**

**Gentiana Sula**

# VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT



## VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIU DHËN

### NËNTOR-DHJETOR

#### AIDSSH, takim në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Më 11 dhjetor, Kryetarja e AIDSSH znj. Gentiana Sula u takua me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Evis Kushi, në kuadër të bashkëveprimit të AIDSSH me Ministrinë e Arsimit, në fushën e edukimit qytetar dhe kërkimit shkencor.

Pasi u njoh me punën dhe botimet e deritanishme të AIDSSH, Ministrja Kushi shprehu gatishmëri për përfshirjen e AIDSSH mes qendrave të vizitueshme studimore nga nxënësit dhe studentët, përgjatë vitit akademik dhe përvojës së tyre shkollore, sa i takon njohjes me arkivin e institucionit, sallën e leximit/ bibliotekën, botimet, ekspozitat tematike për të shkuarën komuniste, zhvillimit të projekteve studimore mbi këtë të shkuar, programeve të përbashkëta trajnuese për mësuesit e historisë, tekstshkruesit e historisë, programshkruesit e lëndëve shkollore të ciklit parauniversitar, në mjediset dhe me burimet e AIDSSH e të partnerëve.

Në vijim të punës së bërë për çështjet dhe personalitetet historike të zbardhura deri më sot, me dokumentacion e studime, u sugjeruan vizita shkollore në vendet e kujtesës, për ndërgjegjësimin dhe njohjen e të rinjve me të shkuarën e afërt, mes të cilëve: Muzeu i Shkencave të Natyrës “Sabiha Kasimati” në Tiranë; vendekzekutimi i 22 intelektualëve të “bombës” në legatën sovjetike, në Mënik, Pezë-Helmës, Tiranë; kampi i internimit në Tepelenë; burgu i Spaçit dhe i Burrelit, për të cilët AIDSSH ka deklasifikuar dosje dhe kontribuar në çështje të të drejtave të njeriut të lidhura me to, ka mbështetur punën kërkimore në arkiva dhe ka bashkëpunuar me institucione, pushtet vendor dhe grupe të interesit.

AIDSSH mbetet e hapur dhe bashkëpunuese për të vënë në dispozicion dokumentacionin që administron për gjysmëshekullin komunist, për të interesuarit në programet master dhe doktoraturë. Sa më sipër do të sanksionohet në një marrëveshje mes AIDSSH dhe MASR.



## Nënshkruhen kontratat për projektet e para ICMP-AIDSSH

Më 10 dhjetor, Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, në mjediset e ICMP Shqipëri, u firmosën marrëveshjet e granteve të para dhënë OJF-ve, në kuadër të projektit “Rritja e ndërgjegjësimit publik për çështjen e drejtësisë tranzitore dhe të pajtimit: trajtimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë komunizmit në Shqipëri”, të zbatuar nga ICMP dhe AIDSSH. Projekti u bë i mundur me përkrahjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.

Përfituesit e parë të granteve të vogla janë Shoqata e ish-të Përndjekurve në Shkodër dhe Fondacioni Kujto.al, mes 9 shoqatave dhe organizatave që veprojnë në fushën e kujtesës historike. Aktivitetet e projekteve të përzgjedhura përfshijnë mbledhjen e të dhënave për personat e zhdukur gjatë komunizmit në Shqipëri, përkrahjen e platformës online të viktimave të komunizmit, analizën e kuadrit ligjor të çështjes së ish-të përndjekurve, ndihmë juridike falas, ekspozitë të artefakteve të të zhdukurve në komunizëm dhe veprimtari të tjera që do të mbahen në të gjithë Shqipërinë, kryesisht në vendet e kujtesës.

Aktivitetet përfshijnë edhe memorializimin, si aspekt i rëndësishëm i drejtësisë tranzitore dhe do të zhvillohen përgjatë vitit 2021.

AIDSSH mbështet punën e organizatave dhe fton të gjithë të interesuarit të kontribuojnë e ndërveprojnë në çështjet e të zhdukurve në komunizëm.





### Shteti nuk është mbi individin

#### Intervistë e kryetares, znj. Gentiana Sula, në RTSH

Më 9 dhjetor, Kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula ishte e ftuar në RTSH, në ciklin “Individi dhe shoqëria”: Shoqëria dhe kujtesa historike, në 30-vjetorin e ndryshimeve demokratike në vend. Gjatë intervistës, znj. Sula trajtoi informimin mbi të shkuarën, zbardhjen e ngjarjeve të rëndësishme historike përmes dokumenteve të Sigurimit dhe arkivave të tjera, bashkëpunimin ndërinstytucional, reflektimin mbi të sotmen dhe projektet e studimit për të nesërmen.

“Nuk mund të vazhdojmë të jemi më peng i së shkuarës, sekreteve të saj ende të klasifikuara për publikun, dekada pas gjysmëshekullit monist të historisë së shtetit shqiptar.

Nga ana tjetër, ballafaqimi duhet të bëhet duhet pasur në qendër dinjitetin njerëzor, individin dhe fatin e tij përballë shtetit dhe makinës represive të policisë sekrete.

Shteti nuk është mbi individin. Aksesi në dokumentet e së shkuarës, - autentike, por të krijuara nga arma e Partisë, Sigurimi i Shtetit, me censurën si pjesë të punës, faktet e retushuara apo të lëna në hije, mijëra dokumente të deklasifikuara dhe qëndrime të bashkëkohësve, familjarëve, historianëve dhe grupeve të interesit që bashkëveprojnë me AIDSSH për zbardhjen e së shkuarës, - ndihmojnë në krijimin e kuadrit historik të kohës.

Ridimensionimi i viktimave të dhunës dhe të dënuarve e ndëshkuarve në komunizëm, trajtimi i temave në vend, në terren, duke hapur dosjet e Sigurimit të zonës përkatëse, si në Konispol, Tepelenë, Përmet, Lushnjë, Belsh, Tiranë, apo sipas tematikave të përzgjedhura për studime shkencore dhe botime, në bashkëpunim me partnerët, si burgjet, dëbimet, internimet dhe puna e detyruar, “armiqtë e popullit” dhe emigracioni politik, tryezat e rrumbullakëta dhe dialogët lokalë, kanë sjellë deklasifikimin e dhjetëra mijëra faqeve materiale sekrete, duke e bërë publikun pjesë të informacionit deri dje të ndaluar dhe ndihmuar reflektimin shoqëror.

Mendimi politik i së majtës shqiptare, me profile biografike, është botimi më i fundit i bashkëpunimit FES-AIDSSH me historianë, nëpërmjet një qasjeje shumëdisiplinore.

Profilet e Sejfulla Malëshovës, Konstandin Çekrezit, Tajar Zavalanit, Musine Kokalarit, Isuf Luzajt, Skënder Luarasit, Petro Markos, Xhavit Qeses, Isuf Keçit, Zef Malës e të tjera personaliteteve, të frymëzuar nga aspiratat për drejtësi shoqërore, renditen në historinë e mendimit politik, krahas atij europian, përtej komunizmit të zbatuar në Shqipëri. Paralelisht po punohet për një projekt që hedh dritë në të djathtën eurve, mendimin e saj politik, nëpërmjet profileve të spikatura, për të sjellë një tablo të plotë të Shqipërisë së kohës,” u shpreh kryetarja Sula.



### **AIDSSH, takime koordinuese në Shkodër për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve e të të ekzekutuarve, si dhe masat për ruajtjen e vendvarrimeve**

Më 4 dhjetor, AIDSSH zhvilloi disa takime koordinuese në Shkodër, në zbatim të ligjit 45/2015 i ndryshuar, dhe bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve e të të ekzekutuarve, si dhe masave për ruajtjen e vendvarrimeve.

Në përgjigje të kërkesës së shtetasit Hamza Kazazi, i cili prej vitesh kërkon eshtrat e të atit dhe u është drejtuar për veprim institucioneve, përfaqësues të AIDSSH, familjarë të viktimave ende të pagjetur, të pushkatuar në zallin e Kirit në Shkodër ose në vendekzekutime të tjera të raportuara, përfaqësues të shoqatës së të përndjekurve politikë në Shkodër dhe shoqatave për të drejtat e njeriut, u bënë bashkë, me dëshirën dhe vullnetin për të kontribuar në kauzën humane të të pagjeturve.

Rruga për identifikimin, rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe për ruajtjen e vendvarrimeve është e gjatë. Të vetëdijshëm për vështirësitë e procesit, dinamikat e rasteve që do të ndiqen dhe bashkërendimit në terren me institucionet, organizatat dhe familjet, AIDSSH dhe partnerët, Policia e Shtetit, Prokuroria, pushteti lokal, shoqatat e të përndjekurve dhe përfaqësues të familjeve e të grupeve të interesit, mbeten të përkushtuar për realizimin e kësaj detyre humane.





## AIDSSH, takim në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Shkodër

Po më 4 dhjetor u zhvillua takimi i ekipit të AIDSSH, të përfaqësuar nga Kryetarja Gentiana Sula, drejtore e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, Ardita Repishti, sekretar i grupit të punës për të zhdukurit në komunizëm, Raklent Çami dhe koordinatorit të projektit ICMP-AIDSSH, Marçel Hila, përfaqësuesit të IIPP, Agron Hoxha, me z. Niko Ibrahimaj, Drejtues i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Shkodër.

Takimi hodhi bazat për bashkëpunim të koordinuar institucional, me detyra e përgjegjësi të përcaktuara për të gjithë aktorët e përfshirë, pushtetin lokal dhe prokurorinë, në zonat e raportuara në Shkodër, Pukë, Qafë-Bari e Spaç.



## AIDSSH, takim me Kryetaren e Bashkisë Shkodër

Pas vizitës në terren, takimit me familjarët e të zhdukurve dhe grupet e interesit, ekipi i AIDSSH takoi Kryetaren e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi, për çështjen e të zhdukurve në diktaturë. Gjatë diskutimit, znj. Ademi mori përsipër përgjegjësitë e pushtetit lokal dhe siguroi përfshirjen e saj në trajtimin e rasteve të raportuara, nëpërmjet bashkëveprimit të institucioneve të varësisë.




## Përrurimi i Qendrës për Drejtësi dhe Transformim

Qendra për Drejtësi dhe Transformim (QDT), e përruruar më 26.11.2020 me koordinimin dhe mbështetjen e Prezencës së OSBE-së, në bashkëpunim me institucione akademike, publike dhe organizata të kujtesës e të drejtave të njeriut, është një nga arritjet për studimin e së shkuarës dhe çështjeve të drejtësisë tranzitore nga këndvështrimi sociologjik, historik, ligjor dhe ai i të drejtave të njeriut.

Mes projekteve, zhvillimi i një Programi Master për Drejtësi Tranzitore parashikon hartimin e moduleve mësimore nga një grup ekspertësh, - në konsultë me Bordin Këshillimor, me përfaqësues nga institucionet publike dhe jopublike, - për identifikimin më të mirë të aspekteve kritike të temave dhe rëndësinë e tyre për ligjërimin shqiptar në Drejtësinë Tranzitore.

Programet master dhe doktoraturë mbi studimin e së shkuarës sonë të afërt në një qendër të dedikuar, janë e ardhmja e punës kërkimore, shkencore dhe edukimit për demokraci, për të cilën AIDSSH mund të kontribuojë gjerësisht.

AIDSSH përfaqësohet në Bordin Këshillimor të QDT me Dr. Ornela Arapin, e Drejtorisë së Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar.



## NJOHJA NXIT STUDIMIN

### Mendimi politik i së majtës shqiptare, profile biografike



Dy botime, ai i studimeve të plota dhe versioni divulgativ në gjuhën shqipe për mendimin politik të së majtës shqiptare, finalizuan projektin njëvjeçar të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Fondacionit Friedrich Ebert në Tiranë.

“Mendimi politik i së majtës shqiptare” është një projekt serioz dhe sfidues që ndriçoi këtë aspekt të historisë sonë të afërt. Dhjetë intelektualë të mirënjohur, filozofë, gazetarë, mendimtarë e përkthyes, shkrimtarë e njohës shumë të mirë të dinamikave në vend e jashtë tij u morën në studim nga një ekip i nivelit të lartë akademik.

4475 faqe dokumente u deklasifikuan nga AIDSSH dhe u vunë në dispozicion të gjashtë studiuesve që iu qasën në mënyrë shumëdisiplinare profileve të përzgjedhura, duke riskuar në të njëjtën kohë tablonë e mendimit politik të së majtës në Shqipëri, në kuadër të mendimit politik botëror të së majtës përgjatë shekullit XX.

Sejfulla Malëshova, Konstandin Çekrezi, Tajar Zavalani, Musine Kokalari, Isuf Luzaj, Skënder Luarasi, Petro Marko, Xhavit Qesja, Isuf Keçi, Zef Mala e të tjerë janë personalitete që u frymëzuan nga aspiratat për drejtësi shoqërore dhe punuan për ta ngritur e formësuar të majtën në vend, si e majtë europiane.

Njohja me historitë e tyre jetësore dhe jo vetëm, i shërben së sotmes, po aq sa të nesërme sonë.

Prezantimi i studimeve pritet në bëhet në një kohë të përshtatshme, përtej kufizimeve të pandemisë.

## **Studime të realizuara në kuadër të projektit të AIDSSH dhe FES për mendimin politik të së majtës shqiptare**

*Shkrimet mund t'i lexoni të plota, të botuara edhe në:*

[https://issuu.com/aidssh/docs/e\\_majta\\_final\\_web](https://issuu.com/aidssh/docs/e_majta_final_web)

### **Xhavid Qesja – Ky sfidant tragjik**

Prof. Dr. Ana Lalaj

*Unë jam kundër jush e, për pasojë, në luftë me ju!*

Xhavid Qesja: një personazh krejt i veçantë në historinë e persekucionit komunist shqiptar. Ithtar i pashoq i doktrinës së Marksit e njëherësh antikomunist i pakompromis. Çfarë ndodhi me djaloshin 19 - vjeçar nga Kruja, i cili më 1941 braktisi origjinën prej nga vinte, me familje e farefis, pronarë tokash e dyqanesh, dhe iu bashkua komunistëve? Pastaj qenë komunistët ata që jo vetëm e braktisën Qesen, por dhe e përplasën tridhjetë vjet në burgje dhe internime. Ky sfidant i rrallë e tragjik që e çoi jetën çuditshëm midis dy skajesh, ekzaltimit për doktrinën dhe urrejtjes për pushtetin, për atë pushtet që u ngrit mbi dhe sipas vetë doktrinës.

### **Skënder Luarasi, patrioti, demokrati dhe opozitari i përhershëm**

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi

Skënder Luarasi është një personazh poliedrik me kontribut të spikatur në letrat dhe historinë e Shqipërisë. Në kapërcyell të viteve '20-'30, Skënder Luarasi njihej nga brezi përparimtar si arsimtari, publicisti, gazetari, përkthyesi, dramaturgu dhe si drejtuesi e bashkëpunëtori i disa organeve të shtypit përparimtar të kohës.

Në këtë punim, Skënder Luarasi do të analizohet në lidhje me qëndrimet e tij politike dhe afinitetin që ai pati me mendimin politik të së majtës.

Skënder Luarasi është pikërisht rasti i intelektualit tek i cili pati një simbiozë interesante të patriotit të interesuar për çështjen kombëtare me parimet e së majtës për barazi, zhvillim, përparim dhe solidaritet. Ai ishte individi intelektual i cili angazhimin politik e quante detyrë. Ai ishte patrioti dhe ithtari i ideve marksiste, që iu imponua shoqërisë me shembullin e tij duke frymëzuar kështu breza të tërë studentësh të përqafonin kulturën si mjetin që do të krijonte një shoqëri të përparuar, të drejtë dhe të barabartë.

### **Isuf Keçi, jeta e një ish-anëtari të Grupit Komunist të të rinjve nën regjimin totalitar**

Dr. Dorian Koçi

Figura e veprimtarit komunist Isuf Keçi, pavarësisht ndryshimit të sistemeve politike nuk është trajtuar ende në dimensionin e tij të plotë përse i përket zhvillimeve të lëvizjes komuniste shqiptare

nga vitit 1941-1951. Ky angazhim politik i tij nuk do të mund të kuptohet nëse nuk analizojmë mendimin e tij politik, të shprehur fillimisht brenda strukturës organizative të Grupit Komunist të të Rinjve, si dhe kontekstin historik të ballafaqimit të pikëpamjeve të këtij grupimi me dogmën zyrtare që ndiqte PKS-h të certifikuar nga emisarët jugosllavë dhe Kominterni.

Familja Keçi klasifikohet në familjet e pasura tiranase. Aktiviteti kryesor ekonomik i familjes ishte tregtia, e cila nëpërmjet gjyshit të Hamitit (Hysen Keçi) dhe sidomos nëpërmjet babait (Ibrahim Keçi) u zhvillua shumë.

Sipas dosjes së tij hetimore dhe dëshmimeve të regjistruara në procesverbalin e marrjes në pyetje në hetuesi, Isuf Keçi deklaroi se është i datëlindjes së vitit 1917 dhe se në vitin 1939 mbaroi Gjymnazin e Tiranës dhe po atë vit shkoi për studime në Torino në Fakultetin Politeknik. Gjymnazi i Tiranës ku Isuf Keçi mbaroi studimet e mesme ishte një qendër e rëndësishme intelektuale dhe fidanishte e mendimit politik. Mes ideve progresiste të modernitetit prej kohësh ishin atashuar dhe idetë komuniste që edhe pse ishin në fillimet e tyre ishin përqaftuar nga rinia e kryeqytetit...

### **Zef Mala, i penduari që nuk diti të heshtë**

Dr. Edon Qesari

Në vitin 1937, Zef Mala, asokohe 22-vjeçar, gjendej mes një grushti themeluesish vërsnikë të një organizatë politike të majtë në qytetin e tij të lindjes, e cila do të njihet më vonë si Grupi Komunist i Shkodrës. Veprimtaria e mirëfilltë publike e Malës kishte nisur pak vite më herët, pasi kishte përmblyllur shkollimin e mesëm në Kolegjin Saverian të Shkodrës – i shquar për drejtimin klasik të curriculum-it të vet mësimor - dhe ishte zhvendosur në Tiranë, më 1934.

Njëkohësisht me përfundimin e një burse studimesh, të financuar nga qeveria shqiptare dhe që e lejon të regjistrohet në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Vjenës, Mala nis të jetë i pranishëm në faqet e shtypit të kryeqytetit, me artikuj të kushtuar kryesisht kronikës rinore dhe përshtypjeve mbi zhvillimet letrare në bashkëkohësi.

Në vijim, Malës do t'i ndërpritej bursa e shtetit. I detyruar të lërë në mes studimet dhe të vendoset sërish në Tiranë, më 1937 Mala afrohet me anëtarët e një celule ndjekësish të ideve të majta të lidhur me qytetin e tij të lindjes. Mes tyre, gjendeshin emra të një rëndësie të veçantë për zhvillimet e mëvonshme politike, si: Tuk Jakova, Vasil Shanto dhe Qemal Stafa (Frashëri, fq. 128), të cilët, në mesvitet '30 ishin bërë të njohur mes shkollarëve të Shkodrës për propagandimin e librave. Zef Mala, që në atë kohë bënte pjesë në redaksinë e gazetës "Arbënia" të Tiranës, nis atëherë rrugëtimin e vet politik. Siç shkruan më vonë, ai do të bëhet edhe nismëtar i disa përkthimeve – kryesisht broshura nga autorë tashmë të renditur si klasikë në literaturën marksiste (Marksi vetë, Lenini, Stalini, Dimitrovi) – që dëshmojnë dhe gjenezën leniniste të formimit të tij fillestar.

### **Petro Marko, një vullnetar jashtë radhëve**

Dr. Edon Qesari

Përfshirja e Petro Markos në hapësirën e një polemike të përgjithshme politike rastis që të ketë një datë nisjeje – të paktën nëse i përmbahemi rrëfimit autobiografik që shkrintari hedh në letër, siç deklaroi, në muzg të viteve 1970 (Marko, fq. 76-77). Duke folur pikërisht për këtë farësoj

zanafile, studiuesi i letërsisë Aurel Plasari rreket t'i japë zhvillimit të këtij të fundit një frymëmarrje më të gjerë se rrethanat shqiptare të asaj kohe:

Debati në fjalë lidhej me një situatë jo vetëm shqiptare: edhe në Europë ishte ndërkoha e “ankesave” të mëdha të artistëve. Të artistëve të bindur se shoqëria – ose më gjerë qytetërimi – u bënte padrejtësi, se borgjezia që kishte zëvendësuar aristokracinë kërkonte prej artit të lajkatonte dhe madje kurtizonte shijen e saj mediokre, se artistit i duhej të flijonte personalitetin e vet, temperamentin, deri edhe stilin nëse nuk donte të vdiste – heroikisht – urie. (...) Në Europën e modernizuar kjo pakënaqësi i ndau opinionet e njerëzve të letrave dysh. Nga njëra anë një opinion romantik, që e refuzonte të tanishmen në emër të nostalgjisë për të kaluarën, duke shkualifikuar borgjezinë dhe duke rivendikuar aristokracinë. Nga ana tjetër një opinion që nuk e kërkonte zgjidhjen të kthimi në të kaluarën, por të një e ardhme më e mirë, me liri dhe të drejta më të mëdha sociale. (...) Në Shqipëri kjo prirje e dytë mund të kishte jetë të vërtetë. Prirja e parë, ajo e imazhit të një aristokracie bujare e të ndriçuar, as që mund të ekzistonte në një vend si Shqipëria me të një të kaluar “anormale” në krahasim me Europën, të një feudalizmi anakronik krejt të palakmueshëm. (Plasari, Petro Marko mes zilisë dhe lavdisë)...

### **Tajar Zavalani, komunisti i zhgënjyer nga stalinizmi**

Prof. Dr. Hamit Kaba

Tajar Zavalani është një nga veprimtarët më aktivë të së majtës shqiptare në periudhën midis dy Luftërave Botërore dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai ka lënë trashëgimi të pasur politike, historike, publicistike, por edhe në fushën e gazetarisë dhe të përkthimeve. Veprimtaria më produktive e tij u zhvillua jashtë Shqipërisë, në BS kur ishte djalë i ri, dhe në Angli [Londër] që nga viti 1940 e deri në vdekjen e tij në vitin 1966. Është vështirë të gjendet një person tjetër i ngjashëm me Tajar Zavalanin, që të jetë endur aq gjatë sa ai, në kërkim të modelit më të mirë për të ardhmen e vendit të vet dhe që të ketë pësuar një metamorfozë të vërtetë të bindjeve të tij politike. Pas LDB, Tajari u shndërrua në një antikomunist i hapur kundër regjimit komunist.

Pikëpamjet e Tajar Zavalanit kanë njohur ndryshime të mëdha nga koha në kohë, dhe punimi është përpjekur të nënvizojë evolucionin e tyre. Jeta e Zavalanit u shoqërua me thyerje të mëdha: nisi si i ri me pikëpamje të majta, për t'u bërë komunist në Bashkimin Sovjetik; u kthye në Shqipëri dhe u largua gradualisht nga komunizmi bolshevik pas zhgënjimeve që pësoi prej tij; u transformua në socialdemokrat gjatë Luftës së Dytë Botërore, për t'u shndërruar në antikomunist pas mbarimit të saj. Edhe në fushën e besimit jeta e Tajar Zavalanit pati ndryshime të mëdha. Lindi në një familje të besimit mysliman të ritit bektashi, u shndërrua në një komunist ateist, për t'u konvertuar në vitin 1958 në katolik, me emrin e ri Thomas-Henry Zavalani. Pavarësisht nga “galopet” në jetën e tij, në personalitetin e Tajar Zavalanit spikasin dy veti thelbësore: kultura e gjerë dhe atdhetaria.

## **Konstandin Çekrezi, i treti i munguari**

Prof. Dr. Hamit Kaba

Konstandin Çekrezi ishte një demokrat liberal me prirje të majta, i cili nuk u pajtua asnjëherë me regjimet autoritare apo totalitare dhe me gjendjen e Shqipërisë së prapambetur, ndryshimit të së cilës i kushtoi gjithë jetën.

“Jeta e tij, - shkruan Ilir Ikononi në parathënien e librit të Andon Andonit për Çekrezin, - ishte një energji e pafund: energji për të shkruar, për të polemizuar dhe për të kundërshtuar autoritetin”

Çekrezi ishte gazetar, historian, publicist dhe politikan i njohur në emigracion. Veprimtaria e tij nisi që në moshë të re në Amerikë, për të vazhduar në atdhe, pas kthimit të tij në vitin 1925, për të kulmuar me krijimin prej tij të organizatës ‘Shqipëria e Lirë’ në Boston në vitin 1941 dhe përpjekjeve për njohjen e saj nga qeveria amerikane dhe britanike. Menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, Çekrezi dha dorëheqjen nga detyra e tij si kryetar i organizatës ‘Shqipëria e Lirë’, të cilën ai e krijoi dhe drejtoi për gati 4 vjet, për shkak të afrimit të saj me regjimin komunist që u vendos në Shqipëri. Deri në vdekjen e tij Çekrezi mbeti partizan i demokracisë perëndimore, i afrimit të Shqipërisë me SHBA, një mediator i papërtuar i pajtimit ndërmjet shqiptarëve me vizione e pikëpamje të ndryshme politike e ideologjike...

## **Midis ëndrrës dhe zhgënjimit, një profil politik për Sejfulla Malëshovën**

Prof. Dr. Ana Lalaj

Në tribunat politike të fillimviteve '90, kur komunistët ishin në ethet e reformimit, ndodhi që opozita e sapoardhur t'u kujtonte atyre se e kishin një model të socialdemokracisë dhe se në vend të portretit të Hoxhës, rrëzuar e pa rrëzuar, mund të vinin atë të Sejfulla Malëshovës.

Po kush ishte Sejfulla Malëshova? Një emigrant politik që mori arratinë kur Ahmet Zogu u kthye në pushtet në dhjetor 1924. Një pasionant në letërsi, por që studioi në një akademi politike - ushtarake. Anëtar i Partisë Komuniste (bolshevike), por dhe në krye të grupit të parë komunist të shqiptarëve, grupit të Moskës, më 1925. Personi ndërlidhës midis Kominternit dhe të dërguarve në Shqipëri për të formuar në këtë vend një parti komuniste. Profesori i filozofisë i cili, më 1943, iu bashkua shtabit të luftës në Shqipëri, duke marrë atje përgjegjësi politike. Autori më potent i programit politik dhe ekonomik të pasluftës, përplasja me Enver Hoxhën dhe... Historianë komunistë dhe jokomunistë, por që janë marrë me komunizmin, kanë plot jetëshkrime të ngjashme për persona historikë të ngjashëm. Megjithatë, çdo klishe “militantiste” nuk ndihmon për të kuptuar Malëshovën e vërtetë. Përtej saj, vlerësimi për këtë individ historik më duket se do mbajtur në disa linja të holla, të ndërmjetme, të cilat, në fakt, gjenden te çdokush, po që në rastin e Malëshovës bëhen përcaktuese të personalitetit të tij.

Që këtë, besoj se marrin përgjigje edhe pyetje të këtilla: Kush ishte Sejfulla Malëshova dhe çfarë përfaqëson ai? Ishte një bolshevik i bindur apo një i majtë i moderuar, ndoshta socialdemokrat, sipas një versioni në qarkullim. Më në fund, ishte ai viktimë e luftës për pushtet apo kurban i ideve të veta?



**Studime të realizuara në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH me ASA, ISKPK, IPPP “Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1944-1990”.**

### **Kujtesa dhe historia në diskursin post-totalitar**

Prof. Dr. Gjergj Sinani

Punimi trajton çështje aktuale si përballja e shoqërisë shqiptare me qasjen ndaj së kaluarës komuniste totalitare; në ç’mënyrë drejtohem i tek e kaluara; vëmendja ndaj dëshmive të të mbijetuarve të terrorit komunist; raportet e reja ekzistenciale mes historisë dhe kujtesës; dallimi kujtesë-histori; krijimi i një shoqërie ku dinjiteti i personit të përbëjë parimin themelor të ndërtimit të institucioneve të reja demokratike dhe të shtetit të së drejtës; përse çdo histori është një histori bashkëkohore, siç shprehej Kroçe.

Orientimi nga një analizë shkencore e së kaluarës nevojitet për rindërtimin shpirtëror të brezave të rinj dhe të atyre që kanë njohur vetëm një histori të manipuluar, atë zyrtare komuniste.

«Ne që kemi jetuar nga kampet e përqendrimit nuk jemi dëshmitarët e vërtetë. Është një ide shqetësuese, me të cilën unë jam bashkuar pak nga pak duke lexuar atë që të mbijetuar të tjerë kanë shkruar, përfshirë dhe mua, kur unë kam lexuar shkrimet e mia pas disa vitesh. Ne, të mbijetuarit, jemi vetëm një minoritet i parëndësishëm, por ama të jashtëzakonshëm. Ne jemi ata që shkelja e detyrës, shkathtësia ose shansi që na ka ndihmuar, nuk e prekëm kurrë fundin.

Këtu historiani gjen përfundimin e një kërkimi thelbësor të konfigurimeve të mëdha historike dhe filozofi gjen më shumë bazën dhe presupozimet që i mundësojnë atij të formojë normat dhe gjykimet vlerore, përmes të cilave do të vlerësojë realizimet e një epoke. Kjo detyrë imponohet për çdo të tashme, sado komplekse qoftë ajo...



*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/10/gjergj-sinani.pdf>

### **Vizatimi i fytyrës së “armikut të popullit” në vitet e para të regjimit komunist**

Prof. Asoc. Dr. Sonila Boçi

Dhuna e ushtruar ndaj një kategorie të popullsisë nuk do të ishte e efektshme, nëse ajo nuk do të mbështetej, ose nuk do të kundërshtohet nga shumica, prandaj propaganda shtetërore shoqëronte çdo zbulim dhe dënim të të ashtuquajturve grupe armiqësore. Mekanizmat e dhunës dhe të propagandës që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar hendekun ndërmjet kundërshtarëve politikë realë apo potencialë me pjesën tjetër të popullsisë, u konsoliduan që në vitet e para të vendosjes së regjimit.

Në filmin Ditët që sollën pranverën, prodhim i Kinostudios “Shqipëria e Re” i vitit 1979, ku trajtohen ngjarje të ndodhura në Malësinë e Madhe në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri zhvillohet një skenë shumë interesante. Aktori Robert Ndrenika në rolin e një partizani së bashku me një koleg të tij ishin caktuar nga Këshilli Nacionalçlirimtar i fshatit për të kontrolluar kishën. Partizani shpreh shqetësimin se ata nuk mund të shkonin në kishë; se kontrolli duhet bërë sipas rregullave që kishte caktuar

Këshilli dhe se ata nuk mund të hynin në shtëpinë e popullit pa leje.

Në këtë moment, Robert Ndrenika i kthen një pyetje shumë intriguese “Po pse, është prifti, popull?”

Qëllimi i këtij punimi nuk është të analizojë konceptin “popull”, por, përkundrazi, të sjellë në vëmendje mekanizmat që u përdorën nga organet shtetërore dhe partiake për të krijuar imazhin e “armikut”, të atij që populli duhet ta shikonte si “të huaj” dhe se si, gradualisht u krijua një kufi ndarës ndërmjet “popullit” dhe kundërshtarëve politikë realë, apo potencialë të regjimit.

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/10/sonila-boci.pdf>

### **Aparati stalinist i dhunës në burgjet e kampet e punës në Shqipëri 1949-1953**

Dr. Dorian Koçi

Komunizmi dhe fashizmi si pjesë të ideologjive totalitare apo murtajave të shekullit, ushtruan terror për të realizuar qëllimet e tyre të inxhinierive sociale. Komunizmi shqiptar ishte derivat i komunizmit sovjetik, i pajisur me asistencë dhe ndihmë jugosllave.

Tmerrri i vërtetë i terrorit është se ai sundon mbi një popullsi plotësisht të nënshtruar. Propaganda është një instrument dhe ndoshta më i rëndësishmi i totalitarizmit, për t’u lidhur me botën jototalitare, kurse terrori është vetë thelbi i formës së tij të qeverisjes.

Në vendet totalitare, propaganda dhe terrori paraqet dy anë të së njëjtës monedhë. Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën, jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinat e tij ideologjike dhe gënjeshtat e tij praktike. Kjo ishte situata që u instalua në Shqipëri menjëherë pas ardhjes në fuqi të komunistëve, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Totalitarizmi u bë i mundur në rrethanat e zhvillimit të teknologjisë së avancuar e të modernizimit të mëtejshëm të të gjitha mjeteve të komunikimit, të armëve dhe të ushtrisë. Këto zhvillime lehtësuan shtrirjen dhe forcimin e kontrollit të gjithanshëm shtetëror. Fried Uillhuid e përcakton totalitarizmin si formë e autokracisë të shek. XX, i cili përdor ide, teknika dhe institucione prej periudhave të mëparshme historike, por të kombinuara me teknologjinë moderne për të krijuar një tip të ri regjimi...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/dorian-koci.pdf>

### **Persekutimi i klerit katolik nga Kosova që shërbeu në Shqipëri gjatë regjimit komunist**

Prof. Asoc. Dr. Gjon Berisha

Në listën e gjatë të martirëve të Kishës Katolike të persekutuar, burgosur dhe vrarë ndodhen edhe klerikë katolikë nga Kosova, të vrarë nga diktatura komuniste me arsyen se kryenin shërbesa në Shqipëri apo “ishin të lidhur me shërbime të huaja”. Shumica e tyre, përveç shërbesave fetare, kontribuan në arsim, kulturë dhe në themelimin e organizata nacionaliste. Të tillë klerikë të lindur në Kosovë, e që shërbyen në Shqipëri, ishin edhe: At Serafin Koda, At Anton Muzaj, Dom Shtjefën Kurti, etj. Të gjithë këta gjeten vdekjen nga regjimi komunistë, përmes pushkatimit, internimit në kampet e përqendrimit me vite të tëra, dhe disa në pleqëri nga plagët dhe nga vuajtjet në burgje.

Në këtë punim, mëtojmë që përmes dokumenteve, të dala nga institucionet e shërbimit të shtetit, e që tani gjenden në Arkivin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (më tej: AIDSSH), të sjellim disa të dhëna, të njohura pjesërisht apo të panjohura mbi arsyet, shkaqet dhe “arsyetimet” që u bënë nga autoritetet e kohës me rastin e internimit apo ekzekutimit të tyre.

Në arkivin AIDSSH kishim fatin të kemi në dorë dosjet gjyqësore të tyre, të cilat janë voluminoze, të mbushura me “vendime në emër të popullit” e “dëshmi” të shumta të fabrikuara që binin mbi barrën e të akuzuarve. Mirëpo, siç dihet, klerikët padyshim qenë patriotë të sinqertë, me opinione antikomuniste dhe me një besnikëri ndaj Kishës së përbotshme dhe atdheut. Kështu, ndjehej se fryma e përgjithshme e Kishës Katolike në Shqipëri, dhe gjithashtu pjesa më e madhe e besimtarëve të saj, nuk e pranuan vullnetarisht komunizmin.

*Studimi mund të lexohet i plotë në:* <https://konferencashkencore.files.wordpress.com/.../gjon...>

## **Vendosja e pushtetit jugosllav në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare (1944-1945)**

Prof. Asoc. Dr. Sabit Syla

Trajtohet problemi sesi faktori jugosllav, nacionalist dhe komunist, bashkohen në qëllimin për ta mbajtur Kosovën brenda Jugosllavisë.

Urdhëresa e Shtabit Kryesor të Serbisë, 2 dhjetor 1944: Në Kosovë nisin masakra, ekzekutime, dhunime, burgosje individuale e kolektive; Organizohet qëndresa shqiptare: Brigada e Drenicës, me komandant Shaban Palluzhën, në dhjetor 1944, me afro 3000 luftëtarë; Në janar-shkurt 1945, mobilizohen rreth 36 mijë trupa kundër Drenicës: Brigada I Kosovë - Metohi, në krye Zufer Musiqi, Brigada e Bokelit apo “Bokelska”, e 6-ta malazeze, Brigada e KNOJ-it, Brigada IV dhe V të Kosovës, Brigadat serbe e maqedone, edhe Brigadat shqiptare; Me urdhër të Titos, 8 shkurt 1945, vendoset Administrim Ushtarak i Kosovës; Mbytet me gjak qëndresa e Drenicës; Pranverë e përgjakshme e 1945: pushkatohen mijëra vetë; mbi 20 000 burgosen ose futen në kampe, mijëra familje izolohehen; mijëra shpërngulen për në Turqi; mbi 6000 veta vriten jashtë kufijve të Kosovës; ndodh një ndër tragjeditë më të mëdha -Tivari.

Çështja e Kosovës ishte problem i vetë shqiptarëve të Kosovës, i forcave politike dhe ushtarake të Shqipërisë së pushtuar, i forcave politike dhe ushtarake të Jugosllavisë, por edhe i vendimeve të Aleatëve të Mëdhenj...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/sabit-syla.pdf>

## **Paligjshmëria e vendimeve të internim-dëbimit në periudhën 1944-1954**

Dr. Çelo Hoxha

Kumtesa trajton çështjen e internimeve dhe dënimeve në aspektin ligjor; veprimet krejtësisht abuzive të pushtetit komunist, të pambështetura në asnjë lloj ligji; izolimin e familjeve të personave kundërshtarë të regjimit në kampe internimi në mbikëqyrjen e ushtrisë ose policisë; situatën e paligjshmërisë kur mijëra vetë u internuan dhe mbaruan internimin përpara sesa të dilte ligji për internimet.

Shtrohet pyetja se si mund ta përkufizojmë, në aspektin ligjor, zhvendosjen dhe izolimin e një mase të konsiderueshme qytetarësh, nga zyrtarët dhe institucionet e shtetit, ndërkohë që mungonin ligjet për një veprimtari të tillë.

Zyrtarisht izolimi quhej internim, ashtu siç ishte quajtur dhe më parë nga institucionet e shtetit shqiptar, por, në ndryshim nga tradita, në rastin e komunistëve nuk pati, për një kohë të gjatë, një ligj për internimet si dënime politike (dënim administrativ, në ligjërimitin zyrtar).

Në këtë studim, kur flasim për atë që zyrtarët e quanin internim, para daljes së ligjit të internimeve (1954), ne e quajmë thjesht izolim i paligjshëm, ndërsa dëbimin, edhe ky një koncept juridik, e quajmë – për kohën që u krye në mënyrë të paligjshme – shpërngulje e paligjshme nga vendbanimi (ose banesa). Ky studim trajton pikërisht aspektin ligjor për internimet dhe dëbimet gjatë regjimit komunist, duke u ndalur në momentet kryesore, për periudhën 1944-1954, kur numri i internimeve dhe dëbimeve ishte më i madh, ndërsa gjendja ligjore, kaotike...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/celo-hoxha.pdf>

## **Vështrim analitik mbi sistemin burgjeve, internimeve dhe përdorimin e punës së detyruar gjatë regjimit komunist në Shqipëri**

Prof. Dr. Beqir Meta

Punimi është një studim mbi mekanizmat e ushtrimit të dhunës gjatë regjimit komunist dhe jep një panoramë mbi sistemin e burgjeve, internimeve, trajtimin e kundërshtarëve të regjimit brenda këtij sistemi, si dhe analizon arsyet e përdorimit të punës së detyruar në këto burgje dhe kampet e internimit.

Vullneti për t'i përjetësuar regjimet komuniste dhe lidhshimin në krye të tyre krijoi një sistem dhune dhe represioni. Mohimi i lirisë dhe të drejtave themelore, sociale dhe politike për individët e një kategorie të shoqërisë, argumentohet nga propaganda zyrtare si një çmim i vogël që duhej paguar për të prekur ëndrrën e paralizueshme të një shoqërie pa klasa, pa pronë dhe pa varfëri.

Regjimet komuniste ndërtuan një mekanizëm të rafinuar shtetëror dhune dhe terrori. Dhuna konsiderohet mjeti i vetëm për marrjen e pushtetit, ndërsa terrori ishte i domosdoshëm për ta konsoliduar dhe përjetësuar pushtetin dhe kultin e individit të lidhshimit komunist.

Qysh në vitin 1918, "ati" i Revolucionit Bolshevik të Tetorit, Vladimir Iliç Lenini do të porosiste drejtuesit komunistë lokalë: "Shokë! Rebelimi i kulakëve në pesë rajonet duhet të shtypet pa mëshirë.

Stalini ka hyrë në kujtesën historike me çibukun e tij në buzë, teksa jepte urdhrin "Të pushkatohet!" apo "Të pushkatohet menjëherë!". Në regjimin e tij, termat e rinj "proletarë", "luftë klasash" ishin rend i ditës. Termat e tjerë të përdorur të cilët do të përqafoheshin nga të gjithë diktatorët komunistë të Europës Lindore e Qendrore do të ishin "revizionistët", "troçkistët", "kulakët", "borgjezët", "sabotatorët". Të gjithë këto terma të "zbuluar" prej Stalinit do të ktheheshin në "besëtytni" për të gjithë komunistët dhe ndjekësit e luftës së klasave dhe të kultit të individit...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/beqir-meta.pdf>

## **Një vështrim mbi rregullimin juridik të punës gjatë periudhës 1944-1991**

Ph.D. Ermal Frashëri

Puna ishte subjekt i rregullimit ligjor nga Kushtetuta, tërësia e normave të kodifikuara mbi punën, disiplinimi i individit, përfshirë edhe masat represuese ndaj tij. Instrumentet në dispozicion të shtetit përfshinin, jo vetëm mekanizmat dhe proceset penale, por edhe instrumentet administrative, si dhe një seri normash sociale mbi tipin ideal të njeriut të ri dhe pritshmëritë

shoqërore lidhur me të. Ky vështrim në thelbin e çështjes është i nevojshëm për të nxjerrë në pah sistemizimin e fenomenit - punë, objektifikimin e individit dhe disiplinimin e shoqërisë nëpërmjet punës.

Maksimumi i hapësirës që i jepet individit, sipas kësaj qasje instrumentale, është të aspirojë dhe veprojë në funksion të përmbushjes së vullnetit të përgjithshëm. Tipar dallues i regjimeve totalitare, dhe këtu hyn edhe versioni shqiptar i komunizmit, është trajtimi dhe rregullimi në skaj i faktorëve kryesorë të jetës dhe prodhimit, dhe në këtë kontekst, ishte normale për atë sistem që puna të trajtohej ashtu si dhe faktorët e tjerë të prodhimit – si p.sh., toka, kapitali, ndërmarrja – të cilat ishin të rregulluara dhe kolektivizuara në funksion të ndërtimit të socializmit.

Pra, kur këta faktorë të tjerë rregulloheshin deri ekstrem, marrëdhëniet e punës nuk mund të ishin përjashtim nga standardi...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/ermal-frasheri.pdf>

### **Pushteti dhe “tjetri” që është përballë (Montimi i regjimit komunist në Shqipëri, 1944-1954)**

Prof. Dr. Ana Lalaj

Kjo trajtesë merret me procesin e montimit të pushtetit që, në terminologjinë e kohës, shpallej si diktaturë e shumicës mbi pakicën, por që në fakt ishte hapur diktaturë e pakicës mbi shumicën, e pjesës mbi të tërën.

Procesi shihet në rrafsh politik, shprehur në platformat politike të komunistëve në pushtet, ashtu edhe në rrafsh legjislativ, fushë e ndërvarur tërësisht nga platforma politike. Në më pak se dhjetë vjet, 1944-‘53, në shoqërinë shqiptare ndodhën thyerje të mëdha. Më tipikja, kundërshtarët politikë vetëm për këtë shkak u thirrën “kriminelë lufte”, “sabotatorë të pushtetit”, “armiq të popullit” e më së shumti, të gjitha bashkë. Kjo ndarje u kthye në epidemi masive, ku pjesë të tëra të popullsisë u gjendën të përjashtuara pa shkak, jo vetëm nga pjesëmarrja normale në jetën sociale, por humbën të drejtat civile dhe nga radhët e tyre u mbushën burgje dhe kampe internimi.

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/ana-lalaj-1.pdf>

### **Gulagu europian: Regjimi i kampeve të punës dhe përqendrimit në Shqipëri, Gjermani Lindore dhe Bullgari, 1946-1950**

Dr. Klejd Këlliçi

Evidentohen dhe krahasohen eksperiencat gjermano-lindore, bullgare dhe shqiptare. Sistemi i kampit u risoll në pasluftë në vendet komuniste, ku partitë komuniste ndërtuan kampe

përqendrimi e pune si një praktikë normale të konsolidimit të pushtetit dhe të kontrollit të popullsisë. Ky proces shihet përmes riprodhimit të modelit të “gulagut” në kampet e përqendrimit dhe punës në Gjermaninë Lindore, Bullgari dhe Shqipëri.

Simbolikisht, fundi i Luftës së Dytë Botërore u shënuar nga proceset e Nurembergut dhe politikave të shpagimit ndaj kriminelëve të luftës apo bashkëpunëtorëve vendas, në një sërë vendesh evropiane përfshi ato të lindjes. Shpagimi preku sidomos individët e përfshirë në drejtimin e kampeve të përqendrimit. Por nëse çlirimi i hapësirave ku këto kampe gjendeshin shënoi dhe lirin e të mbijetuarve, sistemi i kampit u risoll në pasluftë sidomos në vendet tashmë komuniste. Në disa nga këto, menjëherë sapo partitë komuniste përkatëse morën pushtetin, kampet e përqendrimit e të punës u kthyen në një praktikë normale të konsolidimit të pushtetit dhe kontrollit të popullsisë. Ky punim ka për qëllim pikërisht të evidentojë dhe krahasojë tre eksperiencat, atë gjermano-lindore, atë bullgare dhe shqiptare. Ato do të shihen në kuadrin teorik të sovjetizimit si projekt “perandorak” i eksportuar nga BS dhe si formë vetësovjetizimi i vendeve tashmë komuniste. Ky proces do të shihet përmes riprodhimit të modelit të “gulagut” sovjetik në kampet të përqendrimit dhe punës në Gjermaninë Lindore, Bullgari dhe Shqipëri si dhe përkthimit të këtij modeli në praktikë. Punimi do të mbështetet në burime primare arkivore dhe ato sekondare.

Por historia e kampeve as fillon e as mbaron me fundin e LIIB, pse ajo është pjesë e natyrshme e rrugëtimit të shteteve moderne. Në këtë kuptim, rivendosja e kampeve në Europën Lindore mund të shihet si vazhdimësi historike, edhe pse historia e kampeve në hapësirën komuniste filloi të njihej relativisht vonë, pas vendosjes së pluralizmit...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/klejd-kellici.pdf>

## **Trajtimi i së kaluarës në raport krahasues: Shqipëria dhe Europa Lindore**

Dr. Afrim Krasniqi

Trajtohen tiparet kryesore të qëndrimit ndaj së kaluarës në Shqipëri, duke u përqendruar në kategoritë e punës së detyruar dhe të dhunës shtetërore, krahasuar me praktikave të vendeve të tjera ish komuniste si Rumania, Polonia, Çekia dhe Estonia, vende që paraqesin identitete të mjaftueshme përfaqësuese të kornizës së plotë të ndarjes me të kaluarën. Punimi përmbledh analizën politike të procesit të qëndrimit ndaj së kaluarës në këto vende, ecurinë juridike dhe sjelljen shtetërore, si dhe bilancin e deritanishëm të proceseve në rrafsh krahasues.

Tri dekada pas rënies së Murit të Berlinit dhe fundit të Luftës së Ftohtë vendet ish-komuniste ende ndeshen me pasojat e të kaluarës dhe sfidën e përballjes me to. Në Rumani, Bullgari, Poloni, Sllovakia dhe në Çeki debatet mbi të shkuarën komuniste, dosjet sekrete dhe “dekomunistizimin” vijnë të jenë pjesë e agjendës dhe retorikës politike. Në Ukrainë, nismat për dekomunistizimin e vendit kulmuan me ligjin e vitit 2015, debatet dhe efektet e të cilit vijnë të jenë prezent edhe sot.

Gjermania vijon të ketë rol aktiv në dialogun mbi të kaluarën dhe memorien ndaj saj. Në Estoni, më 2015 u iniciua nisma për krijimin e një grupi hetimor ndërkombëtar mbi krimet e komunizmit dhe përgjegjësit e tyre, duke marrë si model praktikave të hetimit dhe të gjyqimit në tribunalin e

Nurembergut. Nismës estoneze iu bashkuan tetë shtete ish-komuniste të Europës Lindore dhe një numër i madh vendesh e institucionesh perëndimore.

Shqipëria nuk i është bashkuar ende kësaj nisme, megjithatë edhe ajo vijon periodikisht të jetë e përfshirë në debat...

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/afrim-krasniqi.pdf>

### **Komunizmi shqiptar: ngjashmëri dhe veçori me vendet e tjera komuniste të Europës Lindore e Qendrore (1944-1948)**

Prof. Dr. Hamit Kaba

Studimi analizon sesi me asistencën e PKJ dhe të shtetit jugosllav, komunistët shqiptarë, - që gjatë Luftës eliminuan kundërshtarët politikë dhe në mungesë të partive të tjera politike, pra, edhe të pluralizmit, - pas luftës morën gjithë pushtetin politik në duart e tyre.

Fshehja dhe manipulimi i këtij realiteti pas të ashtuquajturit Front Demokratik, duke e lënë gjoja PKSHP në ilegalitet, instalimi i një modeli komunist, mungesa e marrëdhënieve diplomatike me SHBA dhe Britaninë e Madhe, lufta e klasave, rënduan gjendjen brenda dhe pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë dhe i dhanë regjimit komunist shqiptar pamjen më të egër në raport me çdo vend tjetër të Europës Lindore.

Në kumtesë trajtohen dhe analizohen dy probleme kryesore që kanë të bëjnë me komunizmin shqiptar, së pari, me rrënjët e tij, të cilat gjenden te Lëvizja Nacionalçlirimtare, dhe së dyti, me veçoritë dhe ngjashmëritë e tij me vendet e tjera ish-komuniste të Europës.

Kumtimi mbështetet kryesisht në burime arkivore shqiptare e të huaja dhe në një numër botimesh mbi shtetet totalitare komuniste të Europës Lindore e Qendrore.

*Studimi mund të lexohet i plotë në:*

<https://konferencashkencore.files.wordpress.com/2019/07/hamit-kaba.pdf>

## PROFILE PERSONALITETESH TË SURVEJUAR NGA SIGURIMI

### Lef Nosi



“Ka qenë 25-vjetori i Pavarësisë, kur dajë Lefi, për të bërë të pamundur falsifikimin dhe manipulimin e dokumentit, e fotografoi dhe e shtypi në qindra kopje, duke ua dhuruar së pari familjarëve të nënshkruesve. Falë këtij kontributi, jo vetëm u bë e mundur ruajtja e tij, i vetmi që kemi nga akti i Pavarësisë, por u shmangën e dështuan përpjekjet e sundimtarëve të ndryshëm për të shtuar si nënshkrues të afërm të tyre”, kujton Skënder Kosturi, një nga nipërit e Lef Nosit.

I lindur në Elbasan në prill të 1877, firmëtari i deklaratës së pavarësisë, Lef Nosi, kishte kontribut të spikatur patriotik, nënkryetar i Klubit “Vllaznia”, themelues i shoqërisë “Afëdita”, i gazetës “Tomorri”, revistës

“Kopështi letrar” e të tjera.

Ministër i Postë-Telegrafëve në Qeverinë e Ismail Qemalit, Lef Nosi është krijues i filatelistë shqiptare. Sipas familjarëve dhe të afërmeve të tij, Qeveria e Vlorës nxori gjashtë emisione pullash, mes tyre ato me shqiponjën dykrenore dhe shkrimin “Shqipënia”.

Veprimtaria e tij në shërbim të Shqipërisë vijoi në shumë drejtime, në hapjen e Shkollës Normale, në kryetar i bashkisë së Elbasanit, kontaktet dhe bashkëpunimet me Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin, Faik Konicën e Fan Nolin, Mit’hat Frashërin e atdhetarë të njohur të kohës, në Janinë, Stamboll, Manastir e Bukuresht, po ashtu, me hulumtimin dhe botimin e dokumenteve me vlerë historike, folklorike, etnografike, me peshë për albanologjinë.

Njohës i disa gjuhëve të huaja, sipas bashkëkohësve thuhej se Lef Nosi kishte bibliotekën e dytë të Shqipërisë, pas asaj të Mit’hat Frashërit, nga e cila, fondi i albanologjisë dhe ballkanologjisë në bibliotekën publike “Qemal Baholli” në Elbasan, mban vulën e tij.

Në vitet 1943-1944, Lef Nosi është një nga anëtarët e Këshillit të Naltë, Regjencës. Në përfundim të luftës, në 1945 arrestohet si kolaboracionist, për t’u dënuar me vdekje në gjyqin publik të 1946. Lef Nosi pushkatohet më 20 shkurt të 1946, me Atë Anton Harapin dhe Maliq Bushatin, në Kodrën e Priftit në Tiranë. I burgosur nga osmanët për veprimtari patriotike në përhapjen e gjuhës dhe arsimit shqip, i internuar nga pushtuesit italianë për aktivitet antifashist, i pushkatuar nga qeveria komuniste e pasluftës si kolaboracionist, Lef Nosit ende nuk i dihet vendvarrimi nga familjarët. Po ashtu, atyre që e strehuan dhe mbështetën....

\*\*\*



Lef Nosi është dekoruar me Urdhrin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” nga Presidenti i Republikës dhe është shpallur Qytetar Nderi i Elbasanit, ku edhe është ngritur shtatorja e tij. Një rrugë dhe një shkollë në këtë qytet dhe në Prizren mbajnë emrin e tij. Studimet e Lef Nosit janë publikuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë.

## Isuf Luzaj



*“Njeriu nuk mund të jetë disa herë i lirë dhe disa here rob; ose ai është gjithmonë dhe krejtësisht i lirë, ose ai nuk është kurrë, kurrë dhe kurrë i lirë”,* thoshte Isuf Luzaj.

Një raport i Sigurimit, pjesë e dosjes nr. 810, e cilëson: “...të gjatë rreth 1.80, me fytyrë të hequr brune, flokë të zes të shtruar, sytë të zes, vetullat të zeza e të përziera në mes, mjekër të gjatë, di me të folur edhe me të shkruarë gjuhën frëngjishte e italishte, njeri shumë i squarë, i dhënë mbas gjuhës dhe letërsisë, njeri kapriços, gjakë nxehët, njeri me kredi e autoritet”.

I larguar më 28 nëntor 1944 nga Shqipëria, ku u kthye pas 50 vjetësh, për t’u prehur në vendlindje, Isuf Luzaj la në Kaninë gruan me 5 fëmijë të mitur. Komisioni për Krimet dhe Kriminelët e Luftës, i mbledhur në 1945 e cilësoi “tradhtar me damkë dhe kriminel të mirënjohur”. Familja e profesorit, e

mbetur në Shqipëri, u persekutua për vite të tëra në internim, ku vdiq e bija 1-vjeçare.

Ndërkohë, karriera e profesorit të diplomuar në Sorbonë, themelues i Ballit Kombëtar dhe Partisë Socialdemokrate njohu vetëm rritje, nga puna në Bibliotekën e Vatikanit, në Argjentinë, në Universitetin e Buenos Airesit e më tej në SHBA, në universitetet e Neë Hampshire, Barat College-Lake Forest, Illinois, Colombia, Harvard, St Joseph College, Indiana College.

Për meritat e tij akademike në filozofi mori titullin honorifik “Profesor i Amerikës”, i cili iu dorëzua nga Presidenti Regan.

\*\*\*

Isuf Luzajn dhe kontributin e tij AIDSSH e solli në vëmendje Ditën Botërore të Filozofisë, e cila është “një mjet i vlefshëm për të menduar për ndryshimin; në të njëjtën kohë, qasje që promovon dialogun dhe tolerancën”.

Profili i Isuf Luzajt është trajtuar gjerësisht në projektin mbi mendimin politik të së majtës shqiptare, bashkëpunim i AIDSSH me Fondacionin Friedrich Ebert në Tiranë.

## Musine Kokalari



“Filloi lufta e Tiranës, - kujton Musine Kokalari në librin e vet “Si lindi Partia Social-Demokrate” (1972). “Më 12 nëntor m’i morën dy vëllezër e shumë veta në lagje i vranë ‘ushtarakët çlirimtarë’. Më 13 nëntor më arrestuan”.

Kokalari u lirua më 28 nëntor, e vetëdijshme se lirisë i kishte ardhur fundi.

“Filloi tragjedia e individit demokrat, - shkruan ajo, - nën diktaturën e proletariatit. Kështu u mbyll epoka e Rilindjes dhe tendenca demokratike nga pozita humaniste që mbron popullin e thjeshtë, njeriun e punës për të shpëtuar nga skllavëria fizike dhe shpirtërore dhe dinjitetin njerëzor. Hyri dhuna dhe gjakderdhja për të shfarosur demokracinë dhe gëzimi mizor për gjakderdhje, me forcë e mospërfillje”.

Musine Kokalari u arrestua më 23 janar 1946 me akuzën se, si socialdemokrate, solli përçarje gjatë luftës.

Të njëjtën akuzë i patën bërë ballistët kur ajo i pat lajmëruar për formimin e Partisë Socialdemokrate. E mbajtën 17 ditë në burg.

Qëndrimi i saj në gjyq ishte shuplakë ndaj regjimit dhe dëshmi e forcës morale që intelektualët po tregonin kundrejt totalitarizmit. U mbrojt vetë, pa avokat, ku mes argumenteve spikati “Unë nuk kam nevojë të jem komuniste të dua vendin tim. Unë mendoj ndryshe nga ju, por unë e dua vendin tim. Ju jeni duke më ndëshkuar për idealet e mia!”.

Më 2 korrik të vitit 1946 Musineja u dënua me 20 vjet burg nga Gjykata Ushtarake e Tiranës, si sabotatore dhe armike e popullit. Nisi kalvari i internimeve komuniste që e çoi nga Tirana, në Burrel, Shkodër e Rrëshen, deri në fund të jetës, ku mbylli sytë.





AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

---

Adresa  
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë  
[www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)